



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E OBILIQIT
DREJTORIA E ADMINISTRATES PERGJITHSHE
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 11 - 398

Data

06.05.2021

Br.

Republika e Kosovës

Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L- 139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të dt. 28 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91), nenit 83 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, si dhe të nenit 73.1 të Statutit të Komunës Nr.I-34 të dt. 25.04.2016 dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-198 dt.25.11.2019 për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik , Kryetari i Komunës si organ shpronësues merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR


1. **MIRATOHET** shpronësimi i Njesisë Kadastrale në Zonën Kadastrale Plemetin Komuna Obiliq për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik realizimi i projektit kapital i cili lidh fshatrat e Qyqavicës përmes Plemetinit me fshatin Milloshevë , pra bëhet fjalë për rrugën " Hoxhë Ali Qerkezi" Milloshevë sipas Vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit Nr.I-198 të dt.25.11.2019 si në vijim :

Njësia Kadastrale gjenden në zk.Plemetin Komuna Obiliq dhe atë si në vijim:

- Njësia Kadastrale P-72602052-00784-2 , Lloji i shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore; Shfrytëzimi aktual i parcelës : Ara ; Kualiteti i Klasës:Arë e kl.5 ; Sipërfaqja :2354 m² ; Vendbanimi – Adresa:Utrina Utrina , e evidentuar në Certifikatë në emër të Hyseni Avni (Mehdi) Pjesa e Pronës 1/1 , nga Plemetini K.Obiliq .
2. Pjese integrale e këtij vendimi është Akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme/Ministria e Financave në të cilin është përcaktuar shuma e kompenzimit për pronarin të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilit i janë prekur nga procesi i shpronësimit.
 3. Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar , do të njoftohet me Vendimin Përfundimtar dhe me Akti e vlerësimit të punuar nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme/Ministria e Financave në të cilin është përcaktuar shuma e kompenzimit pronari i këtyre Njësive Kadastrale të cilat do të shpronësohen .
 4. Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar , i njejt i do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një Gazetë me tirazh të madh në Kosovë .

5. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të tij, Pronari ose Zotrues i Interesit në pronën e paluajtshme ose në të drejtat pronësore që janë objekt i këtij Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili pretendon se ka një interes të drejtëpërdrejtë në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në Vendim, ka të drejtë ankese në Gjykatën Themelore në Prishtinë vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të dt. 28 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91) .
6. Brenda 5 ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në Gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë 5 (pesë) kopje të ankesës të cilat do të dorëzohen fizikisht Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues – Komuna e Obiliqit, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse .
7. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Financave që brenda afatit prej dy (2) vite, që të paguaj plotësisht shumën e kompensimit sipas Aktit të Vlerësimit të përgaditur nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës .
8. Ky vendim paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarit të ri .Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi,Zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një Gazetë me tirazh me të madh në Kosovë.

Kryetari i Komunës



Xhafer Gashi

T'i dorëzohet:

- Pronarit ;
- DPUKP-së ;
- DEFZH-së dhe
- Arhives Komunale.